



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR  
Koordinatori Institucional i projektit EntrAL, Erasmus Plus

Nr. 1198 Prot

Gjirokastër, më 14/09/2022

**Lënda: Kërkesë për akreditim të moduleve të trajnimit të stafit akademik dhe studentëve të UGJ-së në kuadër të projektit EntrAL**

**SENATIT AKADEMIK**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 1; Statuti i UGJ-së Neni 4 & 5; Rregullorja e UGJ-së, neni 8 pika 5, si dhe bazuar në Marrëveshjen e partneritetit dhe Memorandumit të Mirëkuptimit mbi funksionimin e rrjetit AEN të qendrave LLL, neni 2 pikat b, c & neni 4 pika 1, firmosur në Kuadër të Projektit "EntrAL", me qëllim që të mundësohet pilotimi i moduleve të trajnimit, produkt i projektit në fjalë, kërkohet:

1. Të shqyrtohet dhe të akreditohet moduli për trajnimin e stafit akademik të UGJ-së
2. Të shqyrtohet dhe të akreditohet moduli për trajnimin e studentëve të UGJ-së
3. Të merren masat e nevojshme për integrimin e këtyre moduleve në veprimtarinë e Qendrës të të mësuarit gjatë gjithë jetës, LLL.

Bashkangjitur kërkesës do të gjeni arsyetimin mbi rëndësinë e trajnimit në fjalë, shoqëruar me variantin e përkthyer të dokumentit final të secilit modul trajnimi, produkt të projektit EntrAL, konceptuar dhe zhvilluar respektivisht nga grupet e punës të UGJ-së dhe UAMD-së, nën koordinimin e partnerëve europianë të projektit EntrAL.

**Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,**

**Koordinatori Institucional i projektit EntrAL, Erasmus Plus  
Prof. Dr. Gëzim Sala**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR  
REKTORATI

Nr. 1419 Prot

Datë 08/11 2022

**VENDIM**

Nr. 11, datë 08.11 2022

**PËR MIRATIMIN E MODULEVE NË KUADRIN E PROJEKTIT EntrAL**

Bazuar nenin 40 pika 4 të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenin 23 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 08.11.2022, diskutoi për akreditimin e moduleve të trainimit të stafit akademik dhe të studentëve të UGJ-së në kuadrin e projektit të BE EntrAL dhe

**VENDOSI**

1. Të miratoj akreditimin e modulit për trainimin e stafit akademik të UGJ-së;
2. Të miratoj akreditimin e modulit për trainimin e studentëve të UGJ-së, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi;
3. Qendra e të mësuarit gjatë gjithë jetës, LLL, të realizoj integrimin e këtyre moduleve;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
5. Vendimi i përcillet Senatit Akademik për procedim të mëtejshëm.

**REKTOR**

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1411 Prot

Datë 08/11 2022

**VENDIM**

**Nr. 32, datë 08.11 2022**

**PËR MIRATIMIN E MODULEVE NË KUADRIN E PROJEKTIT EntrAL**

Bazuar nenin 40 pika 4 të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenin 19 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej; vendimin e Rektoratit nr.11, datë 08.11.2022., Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 08.11.2022, diskutoi për akreditimin e moduleve të trainimit të stafit akademik dhe të studentëve të UGJ-së në kuadrin e projektit të BE EntrAL dhe

**VENDOSI**

1. Të miratoj akreditimin e modulit për trainimin e stafit akademik të UGJ-së, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Qendra e të mësuarit gjatë gjithë jetës, LLL, të realizoj integrimin e këtyre moduleve;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

  
**Prof.dr.Bektash MEMA**

